



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PRRENJAS

Nr. _____ prot.

Prrenjas, më 11.06.2024

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Transporti i mbetjeve urbane për në Incenerator (Elbasan)”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):
24440000-0

VLERA E FONDIT LIMIT: 4,512,667 (katër milion e pesëqind e dymbëdhjetë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH .

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Prrenjas ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”i ndryshuar

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Kjo pikë plotësohet me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2022 dhe 2023 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 30 % e vlerës së parashikuar të kontratës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike". Në përcaktimin e vlerës së xhiros autoriteti kontraktor është referuar në pikën 2, gërma (c) të Nenit 43, Seksioni III të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

2.2.2. Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm Operatori ekonomik duhet të paraqesë kopje të certifikuara të bilanceve të 2 (dy) viteve të fundit financiare (2022, 2023) të paraqitur në Autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave dhe të konfirmuara nga ky Autoritet. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin nr. 9920 date 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, dhe aktet nenligjore në zbatim të tij.

2.2.3 Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2022 dhe për vitin 2023 sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për

sistemin e taksave vendore”, (i ndryshuar). Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës. *(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotesimin e formularit të vetedeklarimit, dokumentet përkatëse vërtetuese do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar sipas Nenit 76 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; Kreut V, Seksioni III, Nenin 43, pika 6 të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” si dhe sipas Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar). Duke qenë se Autoriteti Kontraktor, Bashkia Prrenjas, është njësi e vetëqeverisjes vendore, e cila funksionon dhe ka kompetenca të përcaktuara sipas Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Njësia e Prokurimit argumenton se pika 3 është vendosur në kuadër të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar), Neni 5, gërma “c” ku citohet se: “...përcakton numrin e kësteve të pagimit të taksës dhe afatet e kryerjes së tyre, si dhe kushtet lehtësuese në rastet e pagesës së plotë dhe përpara afateve të detyrimeve fiskale”.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera *gjatë tre viteve të fundit*. Vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

-Si dëshmi për përvojën e mëparshme, duhet të paraqitet kontrata e shërbimit, vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, dhe faturat tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

-Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 4/b, neni 55 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar). Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës për kontratat e ngjashme është përcaktuar referuar bazës ligjore sa më sipërcituar dhe vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet. Me anë të këtij kriteri vërtetohet se operatorët ekonomikë kanë përvojë të mëparshme për procedura të ngjashme me objektin që prokurohet si dhe kanë përmbushur me sukses kontratën për të cilën janë shpallur fitues. Kjo tregon se operatori ekonomik është vazhdimisht i angazhuar në treg me kontrata shërbimi, çka rrit besueshmërinë të Autoriteti Kontraktor se në rast shpallje fitues, ekzekutimi i kontratës do të jetë në përputhje me përcaktimet e DST, dispozitat e kontratës dhe planit të zbatimit të kontratës

2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht 2 (dy) punonjës për muajin e fundit nga data e zhvillimit të tenderit. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Shoferë (për makine teknologjike/kamion)	Persona	2
--	---------	---

Për këtë operatorët ekonomikë duhet të paraqesin :

- kontratë pune të vlefshme
- dëshmitë e drejtimit (të vlefshme) lëshuar nga DPSHTRR;
- Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve per muajin e fundit nga data e zhvillimit te tenderit.
- Liste pagesat e punonjesve te plotesuar rregullisht sipas formatit e percaktimeve qe kerkohet nga legjislacioni ne fuqi .

Kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ndërsa dokumentacioni provues, do të dorëzohet vetëm nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Përprokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorëtekonomikë tëdëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

a) Shofer (2)

Jane kerkuar 2 shofer sipas mjeteve qe duhet te dispoje operatori ekonomik

Duke u nisur nga numri i makinerive te kerkuara makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtes 10 ton , raport kompaktimi 1:4-1:6 më pak se 2(dy) copë (mjeti duhet të jetë të paktën i standardit Euro 4); [1 në punë dhe 1 rezervë]

-Eskavator me zinxhir 0.5 m³ 1 cope

Personeli i nevojshëm për transportin e mbeturinave janë dy shofer . Fuqia puntore është përlogaritur bazuar në legjislacionin në fuqi, e argumentuar nga grupi I punes se përlogaritjes se fondit limit.

Kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ndërsa dokumentacioni provues, do të dorëzohët vetëm nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

2.3.3 Per te provuar kapacitetet teknike dhe profesionale operatorët ekonomike duhet te jene te pajisur me Licence e leshuar nga Qendra Kombetare e Licencimit per transportin e mbetjeve jo te rrezikshme (kodi III.2.B).

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41 , të VKM nr.285, datë 19.05.2021, **“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”** i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion licencat profesionale per transportin e mbetjeve jo te rrezikshme, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore. Kjo licence kërkohet per ti vertetuar dhe garantuar AK-së sherbim funksionale dhe realizimin me sukses të kontratës përse i përket realizimit te transportit te mbetjeve objekt prokurimi. , si dhe në nenin 4, pika e 1/b e ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit” i ndryshuar, ku parashikohet se: “leja e mjedisit e tipit B është e detyrueshme për kryerjen e veprimtarive të kategorisë B, lista dhe pragjet përkatëse të të cilave janë përcaktuar në shtojcën 1/B të këtij ligji”.

Në shtojcën 1/B është listuar edhe veprimtaria “Menaxhimi i mbetjeve”.

Në nenin 57/2 të ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar, parashikohet se: ‘Qendra Kombëtare e Licencimit lëshon **licencën për transportin e mbetjeve**, e cila përfshihet në nënkategorinë III. 2.B të fushës III të vendimit nr. 538, datë 26.5.2009 të Këshillit të Ministrave “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga/apo nëpërinjet Qendrës Konibëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta ”, pas miratimit të saj nga ministri”.

Ndërkohë, sipas VKM nr. 538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të licencimit (qkl) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta” : “ Veprimtaria e nënkategorisë III. 2. B specifikohet në veprimtari të tilla si grumbullim, transportim, ruajtje, riciklim, përpunim apo asgjësim i mbetjeve të llojeve të ndryshme”.

Kjo kategori licence i referohet zërave të sherbimeve të parashikuara në preventivin e punimeve objekt prokurimi

2.3.4 Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës së shërbimit:

-Makine teknologjike transportuese me ngarkim fundor ose anesor me kapacitet mbajtes 10 ton , raport kompaktimi 1:4-1:6 2 cope (*mjeti duhet të jetë të paktën i standardit Euro 4*)

-Eskavator me zinxhir 0.5 m³ 1 cope

a) Për mjetet në pronësi duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (akti i pronësisë); b) leje qarkullimi; c) çertifikate e kontrollit teknik (e vlefshme); d) siguracion mjeti (i vlefshëm); e) çertifikatë për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme).

b) Për mjetet e deklaruara me qera duhet të paraqitet: a) kontrata përkatëse noteriale e qerasë e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi b) dokumenti që verteton regjistrimin e tij (akti i pronësisë) c) leje qarkullimi; ç) çertifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme) d) siguracion mjeti (i vlefshëm); e) çertifikatë për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme).

c) Për mjetet e deklaruara që transportojnë mallra të klasifikuara sipas legjislacionit në fuqi të rrezikshme, duhet të paraqitet çertifikatë për transport mallrash të rrezikshëm lëshuar nga institucionet perkatëse (e vlefshme).

d) Për pajisjet teknike, të cilat janë në pronësi të operatorit ekonomik, duhet të paraqitet kontrata e shitblerjes/fatura tatimore e shitjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes ndërsa kur janë të marra me qera duhet të paraqitet kontrata e qerasë, fatura tatimore e shitjes/ kontrata e shitblerjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes. Në rastin kur fatura është lëshuar nga subjekte që nuk janë të regjistruar si tatimpagues të TVSH-së duhet të shoqërohet me kuponin tatimor.

e) Për mjetet dhe pajisjet teknike që ka deklaruar operatori ekonomik duhet të paraqesë foto të qarta për secilin mjet dhe pajisje. Në rastin e mjeteve të treguara duhet të jetë e dukshme ne nje foto te vetme mjeti dhe targa e tij.

- Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë me anë të së cilës pranon verifikimin e mjeteve dhe pajisjeve të deklaruara në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës nga Autoriteti Kontraktor.
- Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës deklaron se mjetet dhe pajisjet e deklaruara nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk jane te deklaruar ne procedurat te shpallura fitues nga Autoriteti Kontraktor, Bashkia Prrenjas.
- Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë për vendndodhjen e mjeteve ne pronesi ose me qera me qellim verifikimi nga Autoriteti Kontraktor.

Kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ndërsa dokumentacioni provues, do të dorëzohet vetëm nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Lloji dhe numri i mjeteve të përcaktuara më sipër janë kërkuar në funksion të kryerjes së zerave të preventivit, dhe volumit të tyre dhe rrjedhimisht fituesi i mundshëm duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

-Makina e nevojshme teknologjike për grumbullimin dhe transportin e mbeturinave urbane si dhe shërbimeve mbështetëse, të kërkuara për realizimin e kontratës, janë të renditura si më poshtë:

-Makine teknologjike transportuese me ngarkim fundor ose anesor me kapacitet mbajtes 10 ton , raport kompaktimi 1:4-1:6 min 2 cope (mjeti duhet të jetë të paktën i standardit Euro 4)

a Makine teknologjike transportuese me ngarkim fundor ose anesor me kapacitet mbajtes 10 ton , raport kompaktimi 1:4-1:6 (mjeti duhet të jetë të paktën i standardit Euro 4)

Kjo në proporcion me natyrën dhe volumin e kontratës, i shërben njëherazi jo vetëm proceseve të punës së parashikuar por njëkohësisht edhe ndikimit të tyre në mjedis dhe ka për qëllim uljen e nivelit të ndotjes që shkaktohet në ajër .Respektimin e normativës së ndotjes në ambient, meqënëse janë mjete teknologjike që punojnë me kohë të zgjatur në qytet dhe për të pasur një nivel të ulët ndotjeje në respektim dhe të normativave teknike të Komunitetit European dhe V.K.M Nr .633 datë 26.10.2018 të Ministrisë së Turizimit dhe Mjedisit I ndryshuar me VKM Nr.154 date 27.02.2019“Për masat kundër ndotjes së ajrit nga shkarkimet e mjeteve motorrike dhe reduktimin e shkarkimeve në ajër të ndotësve të gaztë dhe të lëndës së ngurtë pezull nga motorët me ndezje pozitive dhe ata me ndezje me kompresion që djegin gaz natyror apo të lëngshëm për përdorim në automjete.

b. Makine teknologjike transportuese (**rezerve në raste avarie**) me ngarkim fundor ose anesor me kapacitet mbajtes 10 ton , raport kompaktimi 1:4-1:6 (mjeti duhet të jetë të paktën i standardit Euro 4)

Kjo në proporcion me natyrën dhe volumin e kontratës, i shërben njëherazi jo vetëm proceseve të punës së parashikuar por njëkohësisht edhe ndikimit të tyre në mjedis dhe ka për qëllim uljen e nivelit të ndotjes që shkaktohet në ajër .Respektimin e normativës së ndotjes në ambient, meqënëse janë mjete teknologjike që punojnë me kohë të zgjatur në qytet dhe për të pasur një nivel të ulët ndotjeje në respektim dhe të normativave teknike të Komunitetit European dhe V.K.M Nr .633 datë 26.10.2018 të Ministrisë së Turizimit dhe MjedisitMjedisit i ndryshuar me VKM Nr.154 date 27.02.2019“Për masat kundër ndotjes së ajrit nga shkarkimet e mjeteve motorrike

dhe reduktimin e shkarkimeve në ajër të ndotësve të gaztë dhe të lëndës së ngurtë pezull nga motorët me ndezje pozitive dhe ata me ndezje me kompresion që djegin gaz natyror apo të lëngshëm për përdorim në automjete.

Eskavator me zinxhir me kapacitet të kovës prej 0.5 m3, jo më pak se 1 (një) copë i cili do të realizojë ngarkimin e mbetjeve në mjetin transportues.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Njesia e prokurimit